


Organizatrat e shoqërisë civile në komunitetin serb në Kosovë

Prill
2021

Në mes të perceptimeve
dhe prezantimeve



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb në Kosovë
Në mes të perceptimeve dhe prezantimeve

Botues: KFOS

Për botuesin: Iniciativa e re shoqërore (Nova društvena inicijativa) dhe Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik (Forum za razvoj i multietničku saradnju)

Autori: Jovana Radosavleviq, Dejan Radivojeviq

The original writing language of the analysis is Serbian language.

Lekturimi: Ana Milliqeviq

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajni: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 100

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat Iniciativa e re shoqërore dhe Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve të studimit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

HYRJE 6

Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë 6

02.

OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT 8

03.

PERCEPTIMET E KOMUNITETIT RRETH ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 10

04.

PERCEPTIMET E PARTIVE POLITIKE RRETH ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 19

06.

PERCEPTIMET E QYTETARËVE DHE PARTIVE POLITIKE NGA KËNDVËSHTRIMI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE 21

07.

PËRFUNDIMET 25

08.

REKOMANDIME 26

09.

SHTOJCA I 27

1. Hyrje

Organizatave të shoqërisë civile në Kosovë

“Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponentë thelbësore e çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet dhe trajtohet si e tillë nga institucionet publike. Organizatave të shoqërisë civile në Kosovë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në debatin demokratik dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Ato luajnë një rol aktiv dhe kritik në promovimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe e bëjnë këtë kryesisht pa presion të papërshtatshëm nga autoritetet e Kosovës.”

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, 2020

Numri i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë vazhdon të rritet çdo vit, me një prani dominuese disi konstant në masë në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren. Deri në vitin 2018, ministria kompetente ka regjistruar gjithsej 9,015 organizata joqeveritare vendase dhe 530 të huaja dhe ndërkombëtare. Prej tyre, 96% janë regjistruar si shoqata, ndërsa vetëm 4% janë regjistruar si fondacione. Sidoqoftë, duhet të merret parasysh se shumë shoqata, iniciativa qytetare, klube, grupe fetare veprojnë në mënyrë joformale, pa status ligjor dhe kapacitete financiare. Nga ana tjetër, sipas një studimi të kryer nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), vetëm një pjesë e vogël e organizatave të regjistruara, afro 1,000, janë aktive nga aspekti financiar dhe i programeve.¹ Sidoqoftë, të dhënat zyrtare publike për organizatave të shoqërisë civile nuk janë gjithëpërfshirëse, d.m.th. ato nuk përfshijnë të gjitha informacionet e nevojshme statistikore, nuk ndjekin trendet me kalimin e kohës, nuk japin informacion të detajuar mbi organizatave aktive, kapacitetet e tyre, fushat e veprimtimit, dhe ndër të tjera financat.

Edhe pse organizatave të shoqërisë civile nuk deklarohen mbi bazën e përkatësisë etnike ose ndonjë përkatësie tjetër kur regjistrohen, në praktikë ato zakonisht përqendrohen në punën brenda komunitetit që i përkasin, kryesisht në komunitetin shqiptar dhe serb. Organizatave nga komuniteti serb në shumicën e rasteve janë të vendosura në komunat me shumicë serbe, kryesisht në Mitrovicën e Veriut dhe Graçanicë, dhe adresojnë çështje me rëndësi për komunitet siç janë dialogu në mes të Beogradit dhe Prishtinës, të drejtat e komunitetit jo-shumicë, të drejtat gjuhësore, avokimi, shërbimet dhe marrëdhëniet me institucionet publike. Përveç kësaj, ka organizatave që janë të specializuara ngushtë në fusha të caktuara të punës, të tilla si puna me persona me aftësi të kufizuara, puna me viktimat e dhunës në familje, puna me të rinjtë ose puna me të moshuarit. Nga organizatave dhe shoqatat informale, më të zakonshmet janë shoqatat sportive, shoqatat artistike, si dhe grupet informale të grave dhe të rinjve. Në varësi të çështjeve me të cilat merren dhe fushëveprimtimit, organizatave të shoqërisë civile nga komuniteti serb shpesh bashkëpunojnë me organizatave nga komuniteti shqiptar, organizatave të huaja dhe ndërkombëtare.

¹ Puka, Dren, 2018, *Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile*, Prishtinë: KFOS, f8

Bashkëpunimi bazohet kryesisht në projekte ose nevoja teknike, të stimuluar nga fondet dhe politikat e donatorëve, ndërsa partneritetet strategjike janë të rralla.

Shumica e OJQ-ve veprojnë pa burime financiare, si të ardhurat nga tregu dhe të ardhurat tjera, dhe sigurojnë financat e tyre kryesisht përmes fondeve të projektit, donacioneve dhe tenderëve publik. Përdërisa, në mungesë të të dhënave primare dhe një baze gjithëpërfshirëse për monitorimin dhe analizimin e organizatave të shoqërisë civile, kapacitetet financiare dhe trendet e tyre vështirë mund të monitorohen, burimet sekondare implikojnë një rritje të paqëndrueshme. Rritja e vazhdueshme e shumës totale të kontributeve të paguara nga organizatat e shoqërisë civile, pra punonjësit, paguajnë në fondin pensional, që përbëjnë rreth 3.25% të kontribuuesve total në Fondin e kursimeve, tregojnë rritjen e mundshme të kapaciteteve financiare të organizatave të shoqërisë civile, si për nga aspekti i pagave ashtu edhe për nga numri i të punësuarve.² Nga ana tjetër, ekziston një numër i konsiderueshëm i organizatave që operojnë me më pak se 10,000 euro në vit, si dhe ato që operojnë pa fonde fare. Numri i donatorëve të huaj, pra donacioneve dhe programeve të mbështetjes financiare, është në rënie krahasuar me vitet e kaluara, ndërsa numri i fondeve publike, tenderëve dhe programeve po rritet.³ Ndikimi i këtij ndryshimi në strukturën e donatorëve është ende i panjohur.

Derisa shumica e organizatave të shoqërisë civile varen nga fondet dhe programet nga donatorë ndërkombëtarë dhe të tjerë, disa prej organizatave duket se mbeten të padukshme për të njëjtët

donatorë. Një studim i kryer nga KCSF me donatorë të pranishëm në Kosovë tregon se më shumë se gjysma e donatorëve i konsultojnë vetëm disa organizata me të cilat bashkëpunojnë zakonisht (54%), dhe OShC të konsoliduara dhe të specializuara në fusha të caktuara (60,8%). Për më tepër, i njëjti studim tregon se në mesin e organizatave të shoqërisë civile që nuk kanë pasur fonde, vetëm 2% e tyre janë ftuar për konsultim nga donatorët. Në krahasim me atë, shumica e organizatave me të hyra vjetore mbi 100,000 EUR janë ftuar së paku një herë për konsultim nga donatorët.

Nga ana tjetër, burimi i dytë më i zakonshëm i financimit për organizatat e shoqërisë civile, financimi publik nga institucionet qendrore dhe lokale, nuk ka transparencë. Raportimi publik dhe disponueshmëria e informacionit ndryshojnë nga institucioni në institucion, duke i bërë praktikatat të pabarabarta dhe të diskutueshme. Sipas raportit të Komisionit Evropian, pavarësisht disa përmirësimeve në dy vitet e fundit të rregullave dhe praktikave të financimit publik, kapaciteti i kufizuar i autoriteteve lokale dhe qendrore për të zbatuar në mënyrë korrekte standardet e reja të transparencës dhe llogaridhënies nënkupton që financimi publik i OSHC-ve mbetet në rrezik nga korrupsioni dhe konflikti i interesit.⁴ Në mënyrë të ngjashme, ekziston mospërputhje në qasjen e konsultimit publik, një proces që ka një rëndësi të madhe për organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht për organizatat që merren me politika publike dhe avokim. Sipas raportit të Komisionit Evropian, edhe në këtë fushë ka progres, por të pamjaftueshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për qasjen në të dhëna dhe informata kthyesë.⁵

2 Puka, Dren, 2018, *Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile*, Prishtinë: KFOS, f8

3 Puka, Dren, 2018, *Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile*, Prishtinë: KFOS, f9

4 "Raporti i Progresit për Kosovën* për vitin 2020". Bruksel: Komisioni Evropian, 06 tetor 2020

5 "Raporti i Progresit për Kosovën* për vitin 2020". Bruksel: Komisioni Evropian, 06 tetor 2020

2. Objektivat dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit është të sigurojë të dhëna të matshme mbi rolin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb në Kosovë. Objektiva specifike e hulumtimit është të shqyrtojë se sa qytetarët dhe partitë politike janë të njoftuara me organizatat e shoqërisë civile në përgjithësi, dhe pastaj të paraqesë perceptimet e qytetarëve, partive politike dhe vetë organizatave të shoqërisë civile në lidhje me punën e tyre dhe kontributin e tyre në hapjen e komunitetit serb në Kosovë. Pyetja kryesore e hulumtimit që kontribuon në arritjen e qëllimit të përgjithshëm dhe specifik është: *Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në shkallën e hapjes së komunitetit serb ndaj institucioneve dhe shoqërisë në Kosovë?*

Metodologjia e përdorur në hulumtim përfshin mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare u mbledhën përmes pyetësorëve të qytetarëve, grupeve të fokusit me qytetarë, intervistave me përfaqësues të partive politike dhe intervistave me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Të dhënat sekondare u mbledhën duke shqyrtuar literaturën dhe burimet përkatëse. Metodologjia është hartuar në atë mënyrë që të lejojë tranguhimin e të dhënave dhe të përgjigjet në objektivat të hulumtimit.

Mbledhja dhe analiza e literaturës dhe burimeve përkatëse: Literatura u mbledh në periudhën

verë - vjeshtë 2020 dhe përfshinë disa kategori burimesh: 1) korniza ligjore: ligje, udhëzime administrative, rregullore; 2) raporte zyrtare: të institucioneve ndërkombëtare, institucioneve qendrore dhe lokale, 3) hulumtime: të institucioneve ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, institucioneve arsimore, studiuesve/hulumtuesve të pavarur, 4) të tjera: raporte mediatike, blogje, ese.

Pyetësori për qytetarë⁶: Pyetësori i strukturuar për përfaqësuesit e komunitetit serb mbi temën e organizatave të shoqërisë civile është realizuar në tetor 2020. Pyetësori u plasua dhe hartua nga organizata e shoqërisë civile Aktiv për nevojat e projektit OPEN, pjesë e të cilit është ky hulumtim. Numri i përgjithshëm i të anketuarve, të moshës mbi 18 vjeç, është 582 persona që jetojnë në komunitet me shumicë serbe në Kosovë.

Fokus grupet me qytetarët: Ekipi hulumtues, në periudhën tetor-nëntor 2020, mbajti katër grupe të fokusit me përfaqësues të komunitetit serb, dy në Graçanicë dhe dy në Mitrovicën Veriore. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në fokus grupe ishte 30. Pjesëmarrja në fokus grupe ishte anonime, dhe pjesëmarrësit u zgjodhën sipas mostrës së rastit. Fokus grupet ofrojnë një pasqyrë më të detajuar të qëndrimeve të qytetarëve në lidhje me organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb, perceptimet rreth punës

⁶ Për një pasqyrë të hollësishme të metodologjisë së pyetësorit shih Shtojcën 1.

dhe kontributit të organizatave, si dhe përvojave në komunikim dhe punën e mundshme me to.

Intervistat me përfaqësuesit e partive politike:

Intervistat u zhvilluan në periudhën tetor-nëntor 2020, me gjithsej 4 përfaqësues të partive politike. Intervistat u përqendruan në pikëpamjet e partive politike mbi punën e organizatave të shoqërisë civile në komunitetin serb, pikëpamjet rreth punës dhe kontributit për hapjen dhe pozicionin e komunitetit, si dhe përvojat e tyre në komunikim dhe punë me organizatat. Të gjitha intervistat ishin anonime, dhe përfaqësuesit u zgjodhën në mënyrë selektive, me qëllim të përfaqësimit të të gjitha partive kryesore politike nga komuniteti serb.

Intervistat me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile: Intervistat u mbajtën në muajin nëntor 2020, me gjithsej 7 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Intervistat u përqendruan në kontributin e organizatave për hapjen dhe pozicionin e komunitetit, qasjet e përdorura në marrëdhëniet me komunitetin, si dhe përgjigjen ndaj perceptimeve dhe qëndrimeve të caktuara në lidhje me organizatat e shoqërisë civile, të shprehura nga qytetarët përmes pyetësorëve ose grupeve të fokusit. Të gjitha intervistat ishin anonime, dhe përfaqësuesit u zgjodhën në mënyrë selektive, në mënyrë që të përfaqësojnë organizata dominuese dhe të dukshme, si dhe organizata që kanë në mandatin e tyre avokimin e hapjes dhe demokracisë së komunitetit.



Ekipi hulumtues, në periudhën tetor-nëntor 2020, mbajti katër grupe të fokusit me përfaqësues të komunitetit serb, dy në Graçanicë dhe dy në Mitrovicën Veriore. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në fokus grupe ishte 30. Pjesëmarrja në fokus grupe ishte anonime, dhe pjesëmarrësit u zgjodhën sipas mostrës së rastit. Fokus grupet ofrojnë një pasqyrë më të detajuar të qëndrimeve të qytetarëve në lidhje me organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb, perceptimet rreth punës dhe kontributit të organizatave, si dhe përvojave në komunikim dhe punën e mundshme me to.

3. Perceptimet e komunitetit rreth organizatave të shoqërisë civile




“Organizatat joqeveritare paraqesin një lidhje midis qytetarëve dhe ekzekutivit, ose sektorit publik, ose të paktën ashtu duhet të jetë.»⁷

Mbi 65% e qytetarëve deklaruan se me punën e organizatave të shoqërisë civile nuk janë të njoftuar mjaftueshëm ose nuk janë fare të njoftuar (Grafiku 1). Ky qëndrim i qytetarëve u konfirmua nga grupet e fokusit ku qytetarët vunë në pah se në parim i njohin konceptet e shoqërisë civile, por mund të flasin në një masë më të vogël për punën, mandatin, sukseset ose sfidat e organizatave. Për më tepër, edhe qytetarët që në mesin e miqve dhe të njohurve të tyre kanë persona që punojnë në organizata të shoqërisë civile pranojnë se nuk janë plotësisht të njoftuar për atë


që bëjnë saktësisht këto organizata. Ajo që është gjithashtu interesante është se ekziston një ndryshim i dukshëm në informimin e qytetarëve për organizatat e shoqërisë civile në bazë të nivelit arsimor të tyre (Grafiku 2), dhe moshës (Grafiku 3). Sidoqoftë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusit, pavarësisht nga niveli arsimor, ishin në gjendje të përmendnin disa organizata të shoqërisë civile, kryesisht ato me bazë në komunën në të cilën jetojnë (p.sh. pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në Graçanicë përmendën kryesisht organizata që kanë zyre dhe zbatojnë aktivitetet e projekteve në territorin e komunës së Graçanicës), dhe disa madje ishin në gjendje të cekin fushat e tyre të veprimtarisë. Detajet e punës së organizatave të shoqërisë civile u folën kryesisht nga qytetarë të cilët në një farë mënyre ishin pjesë e punës së tyre. Sipas të dhënave të marra përmes pyetësorit, këta qytetarë janë pak më shumë se 25% (Grafiku 4).

7 Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit


Grafiku 1. Sa jeni të njoftuar me punën e organizatave joqeveritare nga komuniteti serb?




Grafiku 2. Sa jeni të njoftuar me punën e organizatave joqeveritare nga komuniteti serb?



Grafiku 3. Sa jeni të njohuar me punën e organizatave joqeveritare nga komuniteti serb, sipas moshës



Grafiku 4. A keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet të organizuar nga ndonjë organizate joqeveritare gjatë vitit të fundit?




Në përputhje me njohuritë dhe përvojën, qytetarët janë më të prirur të formojnë qëndrime për disa organizata të caktuara, sesa për sektorin civil si të tillë. Sikurse që një pjesëmarrës theksoi: "Mendimi është i ndryshëm. Nuk kam asnjë problem me organizatat që janë më aktive dhe që, për mendimin tim, vërtet përpiqen të bëjnë atë që thonë se do të bëjnë; megjithatë, ka edhe organizata që shikojnë dhe ndjekin vetëm interesat e tyre."⁸ Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës tjetër vuri në dukje se me kalimin e kohës qëndrimet dhe perceptimet e tij ndryshuan, dhe se kryesisht varen nga lloji i aktiviteteve të organizatës, si dhe nga lloji i vetë organizatës. Gjithashtu, qëndrimet e qytetarëve ndikohen nga përvojat personale që ata patën me organizata të caktuara, dhe njohjet personale që ata kanë me punonjësit e tyre. Njëri nga pjesëmarrësit në grupin e fokusit theksoi "Unë besimin në këto organizata e fitova duke marrë pjesë në punëtori, diskutime dhe kështu pasqerë që ato me të vërtetë bëjnë diçka dhe se janë me të vërtetë të përkushtuara në punën e tyre. Kam përshtypjen se ato me të vërtetë synojnë të ndryshojnë diçka."⁹

Organizatave ndaj të cilave qytetarët në përgjithësi kanë qëndrime pozitive janë organizata që kanë një fokus të caktuar, siç janë organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat që mer-

ren me të rinj ose organizata që ofrojnë mbështetje dhe shërbime për viktimat e dhunës në familje. Mbi 42% e qytetarëve besojnë se organizatat e shoqërisë civile kanë një rol shumë pozitiv ose kryesisht pozitiv në përmirësimin e shërbimeve sociale dhe të tjera, krahasuar me 30% të qytetarëve që mendojnë se kanë një rol kryesisht ose shumë negativ (Grafiku 5). Për më tepër, kur u pyetën se me çfarë, sipas mendimit të tyre, duhet të merren organizatat e shoqërisë civile, shumica theksuan ekologjinë, punën humanitare, punën me të rinjtë dhe të ngjashme. Sipas njërit prej pjesëmarrësve në fokus grup: "Organizatave që kontribuojnë në zhvillimin kulturor, sportiv dhe psikologjik të fëmijëve dhe të rinjve janë veçanërisht të mirëseardhura."¹⁰ Nga ana tjetër, sipas argumentimeve të tyre, mund të vërehet se qytetarët në një farë mase barazojnë aktivizmin lokal dhe punën humanitare me organizatat e shoqërisë civile, dhe i fajësojnë për mungesën e të djave. Siç shpjegojnë ata, shoqëria civile duhet kryesisht të udhëhiqet nga motivet për ndryshim dhe përfitim shoqëror, dhe jo për karrierë dhe prosperitet personal, sikurse, sipas mendimit të tyre, aktualisht është rasti me shumë organizata të shoqërisë civile. Kjo mbështetet nga fakti se gati 54% e qytetarëve pajtohen me mendimin se organizatat joqeveritare u shërbejnë interesave personale të punonjësve (Grafiku 6).

Grafiku 5. Cili është roli i organizatave joqeveritare në përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera (geronto-amvisë, asistentë personalë, etj.)




8 Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

9 Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

10 Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit


Grafiku 6. Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: organizatat joqeveritare u shërbejnë interesave personale të punonjësve



Përkundër kësaj, qytetarët e kanë më të vështirë të kuptojnë punën dhe kontributin e organizatave që merren me politikën publike, çështje të politikave të larta, analiza dhe të ngjashme. Siç theksojnë, është e vështirë për ta që të shpjegojnë qartë se ku përfundon dhe ku fillon angazhimi në politikë. "Për shembull, nuk më pëlqen ajo organizatë dhe sinqerisht nuk kam një mendim të mirë për të. Ata merren shumë me disa politika të larta që neve qytetarëve në të vërtetë nuk na duhen këtu. Mendoj se ata duhet të përqendrohen më shumë tek njerëzit."¹¹ Duke marrë parasysh këtë, nuk duhet të jetë befasi që mbi 23% e qytetarëve besojnë se

organizatat e shoqërisë civile kanë një rol kryesisht ose shumë negativ në përfaqësimin e interesave të komunitetit serb (Grafiku 7), ndërsa mbi 25% e qytetarëve besojnë se ato kanë një rol kryesisht ose shumë negativ në përfshirjen e qytetarëve në proceset shoqërore dhe politike (Grafiku 8). Nga ana tjetër, disa qytetarë besojnë se është në rregull të merren me politika dhe çështje politike, dhe se organizatat nuk duhet të parandalohen nga profilizimi i tyre në këtë segment "derisa të mos marrin një pozicion të caktuar politik në lidhje me qasjen e njëanshme ose mbështetjen e një opsioni të caktuar politik".¹²


Grafiku 7. Cili është roli i organizatave joqeveritare në përfaqësimin e interesave të komunitetit serb



¹¹ Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

¹² Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

Grafikon 8. Kakvu ulogu imaju nevladine organizacije u uključivanje građana u društvene i političke procese



Aty ku qytetarët janë pothuajse uniformë në qëndrimet e tyre është transparencja, pra mungesa e transparencës në punën e organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë shumica e qytetarëve nuk janë të njoftuar me punën e organizatave të shoqërisë civile, ata gjithashtu besojnë se është kryesisht detyrimi i organizatave të njoftojnë qytetarët rreth punës së tyre, dhe jo qytetarët të kërkojnë një informacion të tillë. Përveç punës së përgjithshme, qytetarët janë më mosbesues ndaj organizatave të shoqërisë civile kur bëhet fjalë për financat, si në vijim: kush i financon organizatat e shoqërisë civile, si përdoren fondet e marra, përfshirë aspektin e programeve dhe administratës, dhe se kujt i raportojnë në lidhje me to. Kështu, qytetarët njëherit renditën transparencën financiare si aspektin më të rëndësishëm për fitimin e besimit, sepse “njerëzit duan të dinë se çfarë ndodh me paratë që marrin organizatat”.¹³ Sidoqoftë, vetë qytetarët nuk pajtohen plotësisht se çfarë do të thotë transparencë financiare, ose si duhet të zbatohet. Disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit përmendën si shembull publikimin e raporteve gjashtëmuajore ose vjetore të auditorëve, ndërsa të tjerët folën për thjeshtimin e këtyre raporteve për t'i bërë ato më të kuptueshme. Ndonëse, disa qytetarë besojnë se niveli i transparencës varet nga donatorët e projektit, ku në rastet e mbështetjes financiare nga institucionet publike, qofshin ato lokale dhe qendrore, duhet të ketë transparencë të plotë, në mënyrë që qytetarët të dinë se si shpenzohen paratë e tyre.


¹³ Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

“Unë besa mendoj se ka edhe një ligj për këtë, kështu që nëse ke ndonjë dyshim, shkon në komunë ose institucion dhe e parashtron një kërkesë. Sigurisht, ekziston një procedurë që duhet të ndiqet, por në atë mënyrë mund të shohësh se sa para nga buxheti janë dhënë dhe kujt. Kjo është e drejta jonë demokratike”.¹⁴


Një nga arsytet e mosbesimit në transparencën financiare të organizatave, veçanërisht në lidhje me donatorët, është fakti që mbi 60% e qytetarëve besojnë se organizatat e shoqërisë civile ndikohen nga donatorët (Grafiku 9). Raporti me donatorët dhe mungesa e transparencës, ndjekur nga mosnjohja e punës së organizatave të shoqërisë civile së bashku çojnë në mbi 30% të qytetarëve që besojnë se ata po bëjnë punën e tyre në atë mënyrë që të mos u besohet. Një gjë që është pozitive është se i njëjti numër i qytetarëve besojnë se organizatave të shoqërisë civile ende mund t'u besohet (Grafiku 10). Kjo ndarje në qëndrime është në korrelacion me moshën e qytetarëve, kështu që sa më të moshuar janë qytetarët, besimi i tyre zvogëlohet (Grafiku 11).

¹⁴ Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit


Grafiku 9. Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: organizatat joqeveritare ndikohen nga donatorët



Grafiku 10. Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: organizatat joqeveritare bëjnë punën e tyre në mënyrë që t'u besohet



Grafiku 11. Qëndrimi nëse organizatat joqeveritare bëjnë punën e tyre në mënyrë që t'u besohet, sipas moshës




Përveç ndikimit të supozuar të donatorëve në organizatat e shoqërisë civile, qytetarët gjithashtu besojnë se organizatat nuk janë të pavarura në punën e tyre për shkak të presioneve politike dhe raporteve me partitë politike. Kështu që, besimi te organizatat gjithashtu varet nga fushëveprimi i tyre, qëndrimet politike dhe marrëdhëniet me partitë politike ose përfaqësuesit politikë. "Qytetarët kanë më shumë besim në organizatat që janë

politikisht neutrale, përkatësisht që nuk janë të lidhura me ndonjë parti politike."¹⁵ Kur merren parasysh këto qëndrime, nuk është për t'u habitur që 45% e qytetarëve nuk pajtohen ose plotësisht nuk pajtohen me mendimin se organizatat e shoqërisë civile janë të pavarura në punën e tyre (Grafiku 12).

¹⁵ Pjesëmarrës/e i/e grupit të fokusit

● **Grafikon 12.** Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: organizatat joqeveritare janë të pavarura në punën e tyre




4. Perceptimet e partive politike rreth organizatave të shoqërisë civile

Ndryshe nga qytetarët, partitë politike janë kryesisht të njoftuara me organizatat e shoqërisë civile, punën dhe përfaqësuesit e tyre. Sipas njërit prej përfaqësuesve, në pothuajse të gjitha partitë politike ka njerëz që filluan karrierën e tyre duke punuar në organizata të shoqërisë civile, dhe ata i morën këto njohuri dhe aftësi me vete. Për më tepër, partitë politike po përpiqen të ndjekin punën e organizatave të shoqërisë civile, kryesisht në fushën e demokratizimit, politikave publike dhe të drejtave të komunitetit serb. Gjithashtu, në varësi se në cilat qytete dhe fshatra partitë e dhëna politike kanë një fortesë, ku i kanë selitë e

partive të tyre, ose ku thjesht jetojnë politikanët, ata përpiqen të njihen me punën e organizatave lokale, ose ato që kanë projekte në komuna dhe fshatra në fjalë. Sipas njërit prej të anketuarve, “sektori i OJQ-ve është shumë i rëndësishëm për komunitetin serb, kryesisht sepse si mekanizëm është neutral dhe nuk i përket asnjë partie politike, kështu që nuk varet nga ajo”.¹⁶ Ajo që është interesante është se qytetarët në një farë mase e vënë në dyshim këtë neutralitet, ku mbi 30% e qytetarëve besojnë se organizatat e shoqërisë civile janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të partive politike (Grafiku 13).

Grafiku 13. Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: organizatat joqeveritare ndikohen nga partitë politike



¹⁶ Intervistë, përfaqësues/e i/e një partie politike

Sidoqoftë, përkund që besojnë se organizatat e shoqërisë civile janë të rëndësishme për komunitetin serb, politikanët besojnë se përfaqësuesit e tyre nuk i përdorin plotësisht kapacitetet dhe njohuritë e tyre. Siç thonë ata, ekziston një hendek i madh midis asaj që është shkruar “në letër” (p.sh. në statutin e organizatës) dhe asaj që shihet në praktikë. Një nga arsytet për këtë është varësia nga donatorët dhe politika e donatorëve, e cila u vu re jo vetëm nga qytetarët, por edhe nga përfaqësuesit politikë:



“Nuk është vetëm faj i organizatave, përgjegjësia bie edhe mbi donatorët, sepse ata nuk janë të interesuar për asnjë lloj stimulimi, në drejtim të zgjatjes së projekteve dhe iniciativave të caktuara. Si rezultat, projektet bëhen jo strategjike, sepse nuk janë planifikuar në planin afatgjatë dhe kontributi i tyre bëhet i diskutueshëm.”¹⁷

Një politikë e tillë e donatorëve, thonë ata, ka bërë që organizatat të përqendrohen në kërkesën e vazhdueshme për mbështetje financiare dhe të veprojnë disi si biznese. Ajo që është interesante është se, si qytetarët, disa përfaqësues politikë barazojnë aktivizmin lokal dhe punën humanitare me organizatat e shoqërisë civile, dhe i fajësojnë për mungesën e aksioneve humanitare dhe se organizatat “nuk u kushtojnë vëmendje nevojave themelore të qytetarëve”.¹⁸ Gjithashtu, disa nga përfaqësuesit politikë besojnë se të gjitha organizatat, pavarësisht nga fushat në të cilat punojnë, duhet të përqendrohen në mobilizimin e të rinjve dhe angazhimin dhe edukimin e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme. “Në shoqëritë normale, OJQ-të janë organe të veçanta që, mbi të gjitha, zhvillojnë kapacitetet e të rinjve në fusha të ndryshme.”¹⁹ Këtu, pikëpamjet e përfaqësuesve të partive politike përkohën edhe një herë disi me pikëpamjet e qytetarëve, të cilët folën në fokus

grupe për potencialet dhe nevojat e organizatave për të mobilizuar të rinjtë, për të ofruar programe praktike, punësim dhe të ngjashme.

Kur bëhet fjalë për organizatat që merren me politikë publike, mbikëqyrjen e institucioneve publike dhe dialogun, përfaqësuesit kanë mendime të ndara. Nga njëra anë, ata besojnë se organizatat që kanë ekspertizë në fusha të caktuara sigurisht që duhet të japin kontributin e tyre, kryesisht në demokratizim, por nga ana tjetër, ata konsiderojnë se organizatat shpesh përdorin pozicionin dhe njohuritë e tyre për t’u pozicionuar mbi partitë politike. Sidoqoftë, një nga bashkëbiseduesit deklaroi se kompleksiteti i realitetit politik në Kosovë ndikon në punën dhe kontributin e partive politike në një masë më të madhe se sa organizimi i shoqërisë civile, dhe nuk ka asnjë kuptim krahasimi dhe radha e tyre. Organizatat e shoqërisë civile, madje edhe ato që merren me çështje me të cilat merren partitë politike, duhet të shihen veçmas, e jo të ndërlidhura me partitë politike, sepse kontributi ose suksesi i tyre për të pasur ndikim në një gjë të caktuar në skenën politike domosdoshmërisht nuk paraprihet nga dështimi i një partie politike.

Kur u pyetën për përvojat e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit politikë pothuajse në mënyrë uniforme u përgjigjën se mbështesin komunikimin dhe bashkëpunimin, veçanërisht për çështje me rëndësi për komunitetin. “Bashkëpunimi është gjithmonë i mundur rreth çështjeve të mbrojtjes dhe intereseve të të drejtave të komunitetit, demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik.”²⁰ Një nga shembujt e përmendur të bashkëpunimit janë programet e praktikës në vetëqeverisjet lokale të organizuara për të rinjtë nga organizatat lokale të shoqërisë civile, si dhe programet e trajnimit për punonjësit në institucionet publike që organizatat organizojnë me raste. Sidoqoftë, shembujt më të zakonshëm janë komunikimi i një anshëm, ku organizatat e shoqërisë civile informojnë përfaqësuesit politikë, përkatësisht institucionet në të cilat ata punojnë, rreth projekteve, hulumtimeve dhe të ngjashme.

17 Intervistë, përfaqësues/e i/e një partie politike

18 Intervistë, përfaqësues/e i/e një partie politike

19 Intervistë, përfaqësues/e i/e një partie politike

20 Intervistë, përfaqësues/e i/e një partie politike

5. Perceptimet e qytetarëve dhe partive politike nga këndvështrimi i organizatave të shoqërisë civile

Përfaqësuesit e organizatave, perceptimin e pothuajse prej 65% të qytetarëve që nuk janë të njoftuar me punën e organizatave të shoqërisë civile e shpjegojnë si pasojë e disa faktorëve dhe pjesëmarrësve, duke mos iu shmangur përgjegjësisë së tyre primare. Kjo vetë përgjegjësi pasqyrohet në 1) dhënien e përparësisë së komunikimit me donatorët, organizatat e tjera dhe grupet e synuara, në vend të komunitetit në tërësi, 2) mënyrat e komunikimit me komunitetin, përfshirë mekanizmat, fjalorin dhe aftësitë, 3) inercinë dhe mungesën e kapaciteteve. Megjithatë shumica e përfaqësuesve besojnë se organizatat duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të informuar qytetarët me punën e tyre, ka nga ata që besojnë se kjo nuk është e nevojshme sepse organizatat, varësisht nga fushëveprimi i tyre, kanë grupin e tyre të synuar dhe përpjekja për pjesëmarrje dhe komunikim duhet të kryesisht të drejtohet drejt atij grupi:

“Aktivitetet e vetë organizatave nuk janë të dizajnuara në mënyrë që të merren me masat. Po flas nga këndvështrimi i organizatës që unë përfaqësoj, nuk është detyra jonë të komunikojmë në masë; ne kemi grupet tona të synuara me të cilat punojmë dhe e bëjmë atë mjaft mirë, dhe identifikohemi për nga ato grupe.»²¹

21 Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

Një faktor tjetër janë donatorët që mbështesin financiarisht dhe në mënyra të tjera organizatat e shoqërisë civile, dhe të cilët, ndër të tjera, vendosin standarde për veprimet e tyre. Megjithëse politikat e donatorëve ndryshojnë nga donatori në donator, duke përfshirë fushat e preferuara të veprimit, mënyrat e veprimit, kohëzgjatja dhe vlera e projekteve, ajo që pritet si reagim nga organizatat është pothuajse gjithmonë e njëjtë - performanca, si nga aspekti i programeve ashtu edhe financiar. Sipas njërit prej përfaqësuesve, donatorët janë të përqendruar në raportimin e organizatave mbi performancën dhe financat, dhe jo për efektet që ato organizata kanë në terren, kështu që vetë organizatat përqendrohen në plotësimin e nevojave dhe pritjeve të donatorëve, dhe më pas tek komuniteti.



“Është çështje e mbijetesës dhe vazhdimësisë, sepse organizatat varen nga donatorët, dhe pavarësisht nga statusi, misioni dhe vizioni i tyre, ato përfundojnë duke vepruar sipas inercisë, ku përqendrohen kryesisht në përmbushjen e detyrimeve dhe pritjeve të tyre kontraktuale, dhe pastaj në varësi të kapacitetit, shpesh nuk kanë hapësirë për atë që ka vërtet rëndësi, pra, në komunikimin e punës së tyre me qytetarët.”²²

Një tjetër ndikim i rëndësishëm në dukshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, dhe kështu në familjarizimin e qytetarëve me punën e tyre, janë mediat lokale dhe qendrore që qytetarët përdorin për t'u informuar rreth ngjarjeve aktuale. Mediat zakonisht raportojnë për ngjarjet të caktuara të organizuara për publikun nga organizatat e shoqërisë civile, ndërsa çfarëdo

²² Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

raportim i mëtejshëm mbi punën, kontributin, madje edhe vetë organizatat është sporadik. Për më tepër, shumica e organizatave nuk kanë krijuar komunikim dhe bashkëpunim strategjik me mediat, kështu që shpesh vetë mediat nuk janë të njoftuara me punën dhe kontributin e tyre, dhe për këtë arsye nuk mund të raportojnë për të njëjtat. Së fundmi, shumë media lokale veprojnë ngjashëm si organizatat e shoqërisë civile, ku zbatojnë projekte dhe programe të mbështetura nga donatorët, kështu që fokusi i tyre, si dhe ai i shoqërisë civile, kryesisht shtrihet rreth punës së tyre dhe marrëdhënieve me palët e interesit.

Sidoqoftë, ndoshta sfida më e madhe me të cilën përballen organizatat e shoqërisë civile është mosbesimi i qytetarëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për transparencën financiare. Siç thekson një përfaqësues, ky mosbesim daton që nga vitet 90-ta, kur përfaqësuesit e organizatave u quajtën mercenarë të huaj dhe tradhtarë të vendit; një narrativë që ka mbijetuar në një masë edhe formë deri më sot. Kjo i bën vetë organizatat të ndihen jo rahat duke i bërë operacionet e tyre financiare plotësisht transparente dhe të qasshme. Frika nga thellimi i perceptimeve negative të komunitetit, e ndjekur nga frika e presioneve të mundshme, çon vetëm në transparencë të pjesshme. «E gjithë situata mund të çojë që të bëhemi shënjestër e qendrave të ndryshme joformale të pushtetit, gjë e cila do të krijonte presion shtesë në punën tonë.»²³ Megjithëse edhe pse në parim situata sot është krejtësisht e ndryshme, në kuptim që ka raportim të qartë financiar të projektit tek donatorët, raportim në administratën tatimore, vlerësime të jashtme të auditorëve, të gjithë këta mekanizma nuk u drejtohen qytetarëve dhe publikut të gjerë.

²³ Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile



“Ashtu siç pritet që institucionet publike të jenë transparente dhe t’i bëjnë dokumentet e tyre të disponueshme për publikun, ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile duhet të komunikojnë një informacion të tillë me publikun. Duke filluar nga projektet e tyre, vlerat e projekteve, mënyrën e përdorimit të mjeteve, rezultatet dhe sukseset e arritura.”²⁴

Nga ana tjetër, siç thekson njëri prej përfaqësuesve, thjesht publikimi i raporteve financiare ose të auditimit nuk do të kontribuonte në një kuptim më të mirë të punës dhe menaxhimit financiar të organizatave, duke pasur parasysh se vetë raportet janë shumë profesionale, pakë të thata dhe nuk flasin për punën dhe suksesin e organizatave. Duke pasur parasysh që qytetarët, sipas vlerësimit të tyre, nuk janë mjaftueshëm ose aspak të njohur me punën e organizatave joqeveritare, transparenca financiare është vetëm një pjesë e dukshmërisë së shoqërisë civile. Është e nevojshme të gjendet një masë ndërmjet transparencës dhe informacionit, që qytetarët të marrin dhe të kuptojnë informacionin e kërkuar dhe të formojnë qëndrime bazuar në të.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, shtrohet pyetja se cili është në fakt kontributi i organizatave të shoqërisë civile në komunitet, ndaj hapjes së tij dhe të drejtave të komuniteteve, dhe nëse ky kontribut mund të matet në rast se qëndrimet e qytetarëve për organizata janë të tilla çfarë janë.

Sipas fjalëve të një përfaqësuesi të organizatave të shoqërisë civile, edhe pse qytetarët mund të mos jenë të njoftuar me punën e organizatave të shoqërisë civile, kjo nuk do të thotë që puna dhe ndikimi i tyre nuk pasqyrohet në mënyrë indirekte në të gjithë komunitetin. Me efektin e topit të borës, organizatat arrijnë të depërtojnë tek ata qytetarë

24 Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

të cilët mund të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në aktivitetet e tyre, nuk e njohin punën e tyre ose nuk ndajnë vlerat e tyre. Një përfaqësues thekson se në këtë mënyrë, shoqëria civile gjithmonë i ka parapri ndryshimit në shumë segmente, pavarësisht nga dukshmëria. “Si organizata të shoqërisë civile, gjithmonë kemi qenë në ballë të kërkimit të hapjes, transparencës dhe dialogut të drejtpërdrejtë.”²⁵ Sot, përmes aktiviteteve publike, debateve, hulumtimeve, formave të ndryshme të botimeve, reklamave, organizatat përpiqen të depërtojnë sa më shumë tek qytetarë dhe t’u përcjellin një mesazh të caktuar, me qëllim që vetë qytetarët më vonë ta transmetojnë atë mesazh. Sipas njërit prej përfaqësuesve, qytetarët mund të mos jenë në gjendje të vërejnë disa nga ndikimet që shoqëria civile kishte mbi ta, por që kishte, e që është një tjetër sukses dhe kontribut i organizatave.



“Mendoj se komuniteti serb në Kosovë është mjaft i hapur, çfarëdo që do të thotë kjo, dhe mendoj se organizatat joqeveritare, secila në fushën e vet të veprimtarisë, po ndryshojnë ndjeshëm shoqërinë dhe po sjellin ndryshime pozitive. Duhet të pranojmë se ky është një komunitet tradicional dhe se gjërat këtu nuk ndryshojnë aq lehtë.”²⁶

Nga ana tjetër, nëse nuk do të kishte përfshirje aktive të organizatave të shoqërisë civile, nuk do të ekzistonte asnjë kanal tjetër, përveç kanaleve politike, për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Avokimi politik neutral është i rëndësishëm sepse tregon se problemet me të cilat përballen komuniteti nuk janë politike, edhe pse shpesh janë të politizuara dhe meritojnë më shumë diskutim dhe vëmendje. Siç shumë prej përfaqësuesve theksojnë, falë organizatave të shoqërisë civile, disa çështje serioze e kanë gjetur veten në hapësirën

25 Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

26 Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

publike dhe ndërkombëtare si temë diskutimi dhe më vonë zgjidhjeje; por ato kontribute që nuk janë në nivelin lokal, ose nuk janë lehtësisht të dukshme për publikun nuk janë të identifikuar as në komunitet. Nga ana tjetër, për shkak të politizimit të çështjeve që janë të rëndësishme për komunitetin, turbulencat politike ndikojnë gjithashtu në sektorin joqeveritar dhe progresin që ai arrinë në shoqëri ose në fushën e politikave publike, dhe shpesh kthejnë të gjithë progresin disa hapa mbrapa. Megjithatë, avokimi është një aspekt i rëndësishëm i punës së organizatave të shoqërisë civile, dhe pothuajse çdo organizatë në fushëveprimin e saj ka një praktikë avokimi dhe "çdo organizatë në fushën e saj është avancuar shumë përmes informimit dhe avokimit për të drejtat e komuniteteve në Kosovë - duke filluar nga ato ekonomike, sociale dhe të ngjashme."²⁷

Neutraliteti politik në një mjedis ku pothuajse të gjitha çështjet shihen si politike është shumë i vështirë dhe mbart me vete pasojat e ndryshme, edhe për organizatat e shoqërisë civile. Për të zbatuar projekte, veçanërisht projekte që në një farë mënyre merren me institucione lokale ose qendrore, politika publike, dialog, organizatat duhet të mirëmbajnë komunikimin, dhe në një farë mase të bashkëpunojnë me akterët politikë në ato institucione. Kjo lehtë mund të perceptohet si përkatësi politike ose lidhje me partitë, veçanërisht nëse nuk ka komunikim të qartë rreth një projekti të caktuar. Nga ana tjetër, kritikave mundshme të drejtuara ndaj përfaqësuesve politikë nga organizatat e shoqërisë civile gjithashtu mund të prodhojnë reagime negative të qytetarëve, sepse përfaqësuesit politikë zgjidhen drejtpërdrejt nga vetë ata qytetarë. Të pozicionuara kështu, midis një çekani dhe kudhre, disa organizata vendosin të anashkalojnë çështje potencialisht problematike dhe fusha të punës, ndërsa të tjerët megjithatë zgjedhin t'u kundërvihen mundësive.

27 Intervistë, përfaqësues/e i/e një organizate të shoqërisë civile

6. Përfundimet

Ky hulumtim filloi me pyetjen *si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në shkallën e hapjes së komunitetit serb ndaj institucioneve dhe shoqërisë në Kosovë*; megjithatë, pasi konstatuam se 65% e qytetarëve nuk janë të njohur me organizatat e shoqërisë civile, gjë që më tej u konfirmua në fokus grupe, ekipi hulumtues u mbështet në hulumtimin e perceptimeve të qytetarëve për shoqërinë civile, si një nga pikat e matjes së ndikimit²⁸. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se, përkundër familjaritetit të dobët me organizatat e shoqërisë civile, qytetarët megjithatë kanë formuar mendime të caktuara për to, të cilat ndryshojnë, ndër të tjera, në mesin e brezave, nivelit arsimor, madje edhe vendbanimit. Përveç kësaj, qytetarët që janë të njohur me organizatat kryesisht janë në dijeni për ato me të cilat ata kanë përvojë të drejtpërdrejtë, ose në mesin e tyre kanë njerëz që kanë përvojë të drejtpërdrejtë me to, kështu që mendimi i tyre për të gjithë sektorin formohet në bazë të këtyre përvojave. Gjithashtu, një përqindje e madhe e qytetarëve kanë formuar qëndrime në cilat fusha publike organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë aktive dhe në të cilat jo, gjë që përkon disi me atë që bëjnë një numër i madh i organizatave, siç janë aktivizmi lokal, politika publike, qeverisja e mirë, të drejtat e komuniteteve, të drejtat gjuhësore, teknologjitë e reja, programe të ndryshme për qytetarët, shërbime, përmbajtje kulturore dhe të

²⁸ Megjithëse ky lloj i hulumtimit ka kufizimet e tij, ekipi hulumtues vendosi, meqenëse hulumtimi ishte në vazhdim, dhe rezultatet e para treguan se qytetarët nuk janë mjaft të njohur me organizatat e shoqërisë civile për të folur drejtpërdrejt për ndikimin që këto organizata kanë mbi ta, që të ridrejtojnë kërkimet drejt qëndrimeve dhe bazuar në to të përpiqet të kuptojë ndikimet e supozuara.

ngjashme.²⁹ Nga ana tjetër, qytetarët që janë të njohur me disa aktivitete ose produkte të organizatave të shoqërisë civile, të tilla si festivale, aksione të ndryshme, shërbime, nuk janë në dijeni se kush i zbaton ose i ofron ato. Kjo ndonjëherë nuk është një rastësi ose mos informim i qytetarëve, sepse siç vuri në dukje një nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatat nuk dëshirojnë domosdoshmërisht të prodhohet, veçanërisht diçka unike dhe e vetë qëndrueshme, që është me rëndësi sociale dhe ekonomike për komunitetin, për organizatat, por janë të prirura të kenë "jetën" e tyre të pavarur në komunitet. E gjithë kjo tregon vetëdijen e qytetarëve se organizatat e shoqërisë civile ekzistojnë dhe veprojnë në komunitetin e tyre, dhe se ato kanë një ndikim të caktuar tek qytetarët. Ky hulumtim nuk mund të ofrojë pasqyrë mbi relevancën statistikore ose kauzalitetin e këtij ndikimi, por paraqet një hap të parë në rrugën drejt një studimi të tillë.

²⁹ Qytetarët gjithashtu besojnë se organizatat e shoqërisë civile duhet të merren me mjedisin, punën humanitare, vullnetarizmin, punësimin e të rinjve dhe çështje të ngjashme me të cilat organizatat në përgjithësi nuk merren ose merren në një masë shumë më të vogël. Gjithashtu, pikëpamjet e qytetarëve nëse organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen në politikë të lartë dhe dialog ndryshojnë.

7. Rekomandime

Për organizatat e shoqërisë civile:

- Të krijohet një qasje strategjike e komunikimit me qytetarë, me qëllim të njoftimit dhe informimit të rregullt të tyre rreth punës dhe kontributit të organizatave të shoqërisë civile;
- Të prezantohen para qytetarëve në një mënyrë të qartë dhe të qasshme kapacitetet financiare dhe menaxhuese të organizatave;
- Të njoftohen më mirë me nevojat e komunitetit në fushat e veprimit të tyre, përfshirë potencialet, problemet dhe zgjidhjet e dëshiruara në mënyrë që ta sjellin punën dhe kontributin sa më afër komunitetin dhe t'i përgjigjen nevojave të tij;
- Të krijojnë partneritete me organizata të tjera, përfshirë mediat, me qëllim të zgjerimit të komunikimit dhe punës me qytetarët;
- Të diversifikojnë dhe thellojnë komunikimin me komunitetin ndërkombëtar dhe donatorët për të u konsultuar, shkëmbyer informacion, dhe për të koordinuar aktivitetet;
- Të prezantohen para komunitetit të donatorëve efektet e politikave dhe praktikave të tyre në punën dhe ndikimin e organizatave të shoqërisë civile;
- Të informohen mbi punën dhe mbikëqyrjen ose të përfshihen në punën e organeve këshilluese qeveritare, institucioneve të pavarura dhe mekanizmave të tjerë me rëndësi për komunitetin.

8. Shtojca 1

Metodologjia e pyetësorit për qytetarët:

Periudha: Hulumtimi u realizua në periudhën nga 01 tetor deri më 20 tetor 2020

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Ballë për ballë (F2F), studim në terren (D2D)

Metoda e kontrollit të punës së intervistuesve: Google maps (GPS) live location sharing

Lloji: Letër dhe laps

Instrumenti i hulumtimit: Pyetësori i anketës i përbërë nga 65 pyetje

Mostra: mbi 18 vjeç

Lloji i mostrës: Qëllimi, kuota

Kriteri i përcaktimit të kuotave: Madhësia e komunës sipas numrit të popullsisë sipas kuotave të paracaktuara për komunat dhe vendbanimet në jug (287/300) dhe në veri të lumit Ibër (295/300)

Madhësia e mostrës: 582 të anketuar me vendbanim në komunitetin serb në Kosovë

Intervali i besimit: +/- 5% për dukuri me një incidencë të pritur prej 50%

Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie Duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës së këtij hulumtimi.

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikave publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

